



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

PROJEKT - VENDIM

Nr. 02, Datë 23.10.2019

**PËR
MIRATIMIN E NISMËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË DETAJUAR PËR ZONËN E
RËNDËSISË KOMBËTARE VJOSË - NARTË, BASHKIA VLORË**

Në mbështetje të neneve 7, 9, 10, 18 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit të Nismës për hartimin e Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare Vjosë - Nartë, Bashkia Vlorë, pjesë përbërëse e këtij vendimi, i cili përmban:
 - a) *Nevojën dhe qëllimin për hartimin e PDZRK-së;*
 - b) *Kufijtë territorialë të PDZRK-së;*
 - c) *Kufizimet dhe lejimet e paracaktuara nga planet dhe vendimet në fuqi;*
 - d) *Fazat e hartimit të PDZRK-së dhe dokumentet përbërëse të tij;*
 - e) *Ekspertët/Fushat e ekspertizës dhe aktorët e grupit të punës që do të hartojnë PDZRK-në;*
 - f) *Plani i veprimeve për hartimin, bashkërendimin dhe këshillimin e dokumenteve të PDZRK-së;*
 - g) *Buxheti për hartimin e PDZRK-së;*
2. Grupi i punës me ekspertë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Bashkia Vlorë do të koordinojnë dhe monitorojnë procesin e hartimit të Planit të Detajuar të Zonës së Rëndësisë Kombëtare Vjosë - Nartë, Bashkia Vlorë, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit të Territorit.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të drejtojnë punën për hartimin e dokumentit të PDZRK-së, bashkërendimin e këshillimin me të gjitha autoritetet e planifikimit dhe palët e interesuara, si dhe për paraqitjen për miratim në Këshillin Kombëtar të Territorit, të dokumentit të Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare Vjosë - Nartë, Bashkia Vlorë.
4. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

EDI RAMA

MINISTËR I LINJËS

BLENDI KLOSI

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA